

# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**

**Për Aktivitetin e Prokurimit:**

Nr <sup>1</sup> i prokurimit	634-26-564-1-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: “Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor”.

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**“MEDPLUS SH.P.K.”**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Lebanë, Rr. Pranvera e Lirisë,p.n**

(Adresa)

**Prishtinë**

**10000**

(Vendi)

(Kodi postar)

**+38344640420**

**N/A**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Jeton Prenaj**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**medplusk@gmail.com**

(Adresa elektronike)

**18.05.2026**

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

\_\_\_\_\_  
*(Emri i avokatit)*

\_\_\_\_\_  
*(Adresa e plotë)*

\_\_\_\_\_  
*(Numri i Telefonit)*

\_\_\_\_\_  
*(Numri i faks-it)*

\_\_\_\_\_  
*(Adresa elektronike)*

\_\_\_\_\_  
*(Data e parashtrimit të ankesës)*

\_\_\_\_\_  
*(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Njoftimi për Kontratë: 17.02.2026 Data e hapjes së ofertave: 16.04.2026 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 29.04.2026 Kërkesa për rishqyrtim dt:04.05.2026 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 08.05.2026
---

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 i LPP-së  
Neni 6 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 57 i LPP-së  
Neni 59 i LPP-së  
Neni 60 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së  
Neni 28 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik  
Neni 37 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik  
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik  
LIGJIT PËR ÇMIMIN E PRODUKTEVE MEDICINALE.**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

### 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është publikuar me dt. 16.02.2026, kurse njoftimi mbi vendimin e AK-së formulari B58 është ngrit në sistem me dt.29.04.2026. Nga njoftimi mbi vendimin e AK-së, jemi njoftuar se AK-ja ka rekomanduar për kontratë grupin e OE BRT PHARM SH.P.K&NSHT Neramed, ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

*O.E MEDPLUS SH.P.K. nuk ka plotësuar specifikimin teknik për pozicionin 52, ku tek ky produkt keni ofruar produkte me dallime të mëdha me specifikat e kërkuara nga AK po ashtu edhe në pozicionin 53 keni ofruar produkte që nuk i përmbushin specifikimet e kërkuara nga AK.*

Fillimisht sqarojmë se autoriteti kontraktues, pas kërkesës për sqarime të një OE tjetër në fazën e para ofertimit e ka lejuar ofertimin me produkte të barazvlefshme.

Në lidhje me arsyen e eliminimit, sqarojmë se ne kemi ofertuar me produkte të barazvlefshme, e të cilat nuk kanë dallime substanciale siç ka pretenduar autoriteti kontraktues dhe se specifikimet e ofruara nga ne për këto produkte i përmbushin kërkesat dhe specifikimet teknike, prandaj arsyeja e eliminimit është e paqëndrueshme dhe e pa bazuar.

Për të sqaruar dhe vërtetuar produktet tona se a janë të barazvlefshme, ne kemi kërkuar nga një ekspert gjyqësor -Farmacist-Specialist i Toksikologjisë z. Nardi Sh. Sheqerxhiu, që të përgatit ekspertizë profesionale në lidhje me pyetjet si më poshtë:

#### **PYETJET**

1. Nëse përbërjet aktive kanë efekt të njëjtë dezinfektues dhe funksional,
2. Nëse produktet tona mund të konsiderohen të barazvlefshme në aspektin teknik dhe përdorues,
3. Nëse dallimet në përbërje ndikojnë në performancë apo qëllimin e përdorimit.

**Mendimi i ekspertit në lidhje me produktet për pozicionet 52 dhe 53 është si më poshtë:**

## **MENDIM**

- I. Produkti Actoman 1L dhe produkti i kërkuar në pozicionin 52 nuk kanë përbërje të njëjtë ndërsa përdoren për qëllim të njëjtë, mirëpo asnjë produkt i prodhuar në Bashkimin Europian nuk mund të ofroj produktet dezinfektues për duar me përbërje **Methylidibromo Glutaronitrile** (i kërkuar në specifikat e Autoritetit kontraktues) sepse është ndaluar përdorimi i tij në produkte për lëkurë si shampone, krema etj.
- II. Produkti i ofruar për pozicionin Nr.52 mund të konsiderohet i barazvlefshëm në aspektin teknik dhe përdorues.
- III. Dallimet në përbërje të produktit të kërkuar në dukje të parë është më i avancuar mirëpo prania e substancave të dëmshme dhe të pa lejuara në BE e bën produktin e ofruar më të përshtatshëm ku në përbërje nuk ka substanca kimike alergjente apo substanca të ndaluar për përdorim.
- IV. Produkti Actosept AF 1L nuk ka përbërje të njëjtë kimike të kërkuar në specifikat e Autoritetit Kontraktues, mirëpo përbërje kimike e substancave në produktin e ofruar kanë efekt dezinfektues si dhe dhe përbërje më të lartë të alkoolit dhe më i përshtatshëm për qëllimin e kërkuar në specifika (Dezinfektant për dysheme) për arsye të pranisë së surfaktantit.
- V. Produkti i ofruar për pozicionin Nr.53 mund të konsiderohet i barazvlefshëm në aspektin teknik dhe përdorues.
- VI. Produkti i ofruar ka performancë më të lartë për qëllimin e kërkuar për përdorim në krahasim me produktin e kërkuar përkund dallimit në përbërje.

## **EKSPERTI**

**Nardi Sh. Sheqerxhiu**

Ekspert Gjyqësor -Toksikologji dhe Barna



Nga kjo ekspertizë profesionale, kuptohet se dy produkte ofruar nga ne mund të konsiderohen të barazvlefshme në aspektin teknik dhe përdorues, madje kanë veti apo performancë edhe më të avancuar, prandaj nga kjo ekspertizë rezulton se ne jemi eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet i prokurimit, kështu që kërkojmë që të korrigjohet ky vlerësim dhe të rekomandohemi për kontratë. Komisioni vlerësues me rastin e vlerësimit të ofertave është dashur ti merr parasysh sqarimet e dosjes së tenderit dhe jo të veproj në mënyrë diskriminuese.

- Ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, ku autoriteti kontraktues me dt.04.05.2026 na ka lejuar qasje, ndërsa nga ato dokumente që na janë dhënë rezulton se grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:
  - Mostrat e dorëzuara janë: S&M waschlotion 1L dhe Mikrozid AF Liquid 1L, ndërsa dokumentet që ka dorëzuar janë për Desmanol Pure dhe Sensiva waschlotion.

Pra kemi mos përputhje të dokumentacionit me mostrat e ofruara, prandaj edhe për këtë arsye ky grup i OE konsiderohet i papërgjegjshëm, madje ky veprim i këtij grupi konsiderohet tendencë mashtruese, e të cilën e ka pranuar autoriteti kontraktues si të rregullt.

Specifikimet teknike të grupit të OE të rekomanduar për kontratë nuk janë sipas specifikimeve teknike të dosjes së tenderit, mirëpo pasi është lejuar ekuivalenca konsiderojmë se edhe këto specifika të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë duhet të merren parasysh por jo të diskriminohemi ne, e të favorizohet grupi i OE të rekomanduar për kontratë por të ekzistojë barabarësia në vlerësim e jo të veprohet në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

**-Tek produkti me numër 52,** produkti i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë përmban vetëm 7 exipienca nga 19 që duhet ti përmban produkti i kërkuar nga AK, shih më poshtë katalogun e OE të rekomanduar për kontratë e ku janë të nënvizuara më ngjyrë të verdhë 7 exipienat.

# s&m Waschlotion

## Produktdaten

Zusammensetzung:

Aqua, Sodium Laureth Sulfate, Sodium Chloride, Laureth-3, PEG-7 Glyceryl Cocoate, Phenoxyethanol, Benzoic Acid, Dehydroacetic Acid, Ethylhexylglycerin, Parfum, CI 42051, CI 47005, Sodium Hydroxide, Lactic Acid

### Chemisch-physikalische Daten

Dichte	ca. 1,03 g/cm <sup>3</sup> / 20 °C
Farbe	grün
Flammpunkt	Nicht anwendbar
Form	viskos
pH	5 / 100 % / 20 °C
Viskosität, dynamisch	ca. 1.900 mPa*s / 20 °C / Methode: DIN 53019

## Umweltinformation

Schülke stellt seine Produkte nach fortschrittlichen, sicheren und umweltschonenden Verfahren wirtschaftlich und unter Einhaltung hoher Qualitätsstandards her.

## Gutachten und Information

Einen Überblick zum Produkt finden Sie im Internet unter [www.schuelke.com](http://www.schuelke.com)

Für individuelle Fragen:  
Application Department  
Telefon: +49 40 52100-666  
E-Mail: [info@schuelke.com](mailto:info@schuelke.com)

## Besondere Hinweise

Vor Sonnenlicht schützen. Nur bei Raumtemperatur lagern. Evtl. auftretendes Absetzen von Inhaltsstoffen ist durch Schütteln voll reversibel und beeinträchtigt nicht die Produktqualität.

## Bestellinformation

Artikel	Lieferform	Art.-Nr.
s&m Waschlotion 500 ml FL	20/Karton	112006 PZN: 05702876
s&m wash lotion hyclick 500 ml FL	20/Karton	70000136 PZN: 11146238
s&m Waschlotion 1 l FL	10/Karton	112002 PZN: 04427600
s&m Waschlotion -Euroflasche- 1 l EF	10/Karton	112003 PZN: 06099548
s&m wash lotion hyclick 1 l FL	10/Karton	70000135 PZN: 11146244

## Anwendungshilfen

Anwendungshilfen	Art.-Nr.
hyclick 500 ml Adapter	60000035
hyclick Präparate-Spender 1000 ml	60000036
hyclick Präparate-Spender Vario	60000045
hyclick Tropfschale	60000037
Präparatespender KHK 1000 (ca. 0,8-1,8ml je Hub)	669700
Präparatespender KHK 500 (ca. 0,8-1,8ml je Hub)	669600
Präparatespender KHL 1000	669710
Präparatespender KHL 500	669610
sm 2 500 (ca. 1.0 - 3.0 ml je Hub)	668600
sm 2 Universal (ca. 1.0 - 3.0 ml je Hub)	668500



Die Schülke & Mayr GmbH ist im Besitz einer Herstellungs- und Zulassungsbescheinigung nach §13 AMG Abs. 1 und von GMP-Zertifikaten für Arzneimittel.

Schülke Hauptsitz  
Schülke & Mayr GmbH  
Robert-Koch-Str. 2  
22851 Norderstedt  
Deutschland  
Tel. +49 40 - 52100 - 0  
Fax +49 40 - 52100 - 318  
[www.schuelke.com](http://www.schuelke.com)  
[info@schuelke.com](mailto:info@schuelke.com)

# 390 / 91/00319-01E-de-01-33 7/2022  
Produktinformation wird nicht vom Anzeigebereich erfasst.

Produkti ynë i përmban pesë xipientë, e që do të thotë se as produkti i OE të rekomanduar për kontratë e as i yni nuk janë identik me kërkuesin mirëpo janë ekuivalentë dhe nëse merren parasysh ekuivalenca atëherë duhet të merren si të vlefshëm edhe produkti ynë, e nëse nuk merren atëherë nuk duhet të merren si të vlefshëm edhe produkti i OE të rekomanduar për kontratë e as i yni.

Thjesht po kërkohet që të kemi trajtim të barabartë edhe ne, e jo të diskriminohemi në mënyrë të njëanshme.

**-Tek produkti me numër 53,** produkti i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë përmban vetëm 1 exipientë nga 3 që duhet ti përmban produkti i kërkuar nga AK, shih më poshtë katalogun e OE të rekomanduar për kontratë e ku është i nënvizuar më ngjyrë të verdhë 1 exipient.

## mikrozid<sup>®</sup> AF liquid

### Produktdaten

Zusammensetzung:  
100 g Lösung enthalten folgende Wirkstoffe:  
24,75 g Ethanol (94 %ig), **35 g Propan-1-ol**  
Kennzeichnung gemäß VO (EG) Nr. 648/2004: Duftstoffe

### Chemisch-physikalische Daten

Dichte	ca. 0,89 g/cm <sup>3</sup> / 20 °C
Farbe	farblos
Flammpunkt	27 °C / Methode: DIN 51755 Part 1
Form	flüssig
pH	Nicht anwendbar
Viskosität, dynamisch	nicht bestimmt

### Besondere Hinweise

**Desinfektionsmittel vorsichtig verwenden.**  
**Vor Gebrauch stets Etikett und Produktinformationen lesen.**  
Das Produkt ist gut materialverträglich bei Metallen und Kunststoffen (außer Acrylglas und alkoholempfindlichen Lacken). Besonders alkoholempfindliche Flächen, wie z.B. Acrylglas, dürfen nicht behandelt werden. Bitte beachten Sie den Brand- & Explosionsschutz beim Einsatz von alkoholischen Desinfektionsmitteln in der BR Regel "Desinfektionsarbeit im Gesundheitswesen". Von Hitze und Zündquellen fernhalten. Das Tragen von Schutzhandschuhen wird empfohlen. Weitere Angaben sind auf Anfrage erhältlich. Die Haltbarkeit der Anbruchbinde ist der Verpackung zu entnehmen.  
BAuA-Nr.: N-40579

### Bestellinformation

Artikel	Lieferform	Art.-Nr.
mikrozid <sup>®</sup> AF liquid 250 ml Sprühflasche	10/Karton	109160 PZN: 02877813
mikrozid <sup>®</sup> AF liquid 1 l Flasche	10/Karton	109301 PZN: 02877606
mikrozid AF liquid -NLGRVLV- 1 l FL	10/Karton	70002725
mikrozid <sup>®</sup> AF liquid 10 l	1/Kanister	109102 PZN: 02877807
mikrozid <sup>®</sup> AF liquid 200 l	1/Fass	109111

### Anwendungshilfen

Anwendungshilfen	Art.-Nr.
Druckluftspritze	120001
Kanisterschlüssel für 5 + 10 l	135810
Messbecher 50 ml	136102
Opener all-in-one (1L Euroflasche/Kanister/Fässer)	70000804
schülke Kanisterdosierer 5 l / 10 l (20 ml / Hub)	117101
schülke Kanisterhahn für 5 l / 10 l	135501
Umfülltrichter	117901

### Verwandte Produkte

- mikrozid<sup>®</sup> AF wipes
- mikrozid<sup>®</sup> sensitive liquid
- schülke wipes
- schülke wipes safe&easy

### Umweltinformation

schülke stellt seine Produkte nach fortschrittlichen, sicheren und umweltschonenden Verfahren wirtschaftlich und unter Einhaltung hoher Qualitätsstandards her.

### Gutachten und Information

Einen Überblick zum Produkt finden Sie im Internet unter [www.schuelke.com](http://www.schuelke.com).  
Für individuelle Fragen:  
Application Department  
Telefon: +49 40 52100-666  
E-Mail: [info@schuelke.com](mailto:info@schuelke.com)



Die Schülke & Mayr GmbH ist im Besitz einer  
Herstellungslizenz nach §13 AMG Abs.1 und von GMP-  
Zertifikaten für Arzneimittel.

schülke Hauptnitz  
Schülke & Mayr GmbH  
Robert-Koch-Str. 2  
22851 Norderstedt  
Deutschland  
Tel. +49 40 - 52100 - 0  
Fax +49 40 - 52100 - 318  
[www.schuelke.com](http://www.schuelke.com)  
[info@schuelke.com](mailto:info@schuelke.com)

#112 / 91 0107-DE-de-02-40 5/2014  
Produktinformation wird nicht vom Anwedungsdienst erfasst.

Nga këto dëshmi, kuptohet qartë se ne jemi diskriminuar nga autoriteti kontraktues, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që të shqyrtohen drejtë pretendimet tona ankimore dhe dëshmitë e ofruara nga ne e po ashtu edhe dëshmitë e OE të rekomanduar për kontratë.



Kur kem parasysh këto fakte, vijnë në përfundim se nuk duhet të lejohet të ofertohej në tender me çmime jashtë çmimeve zyrtare por duhet eliminuar operatori ekonomik. Po ashtu institucionet janë të obliguara të kujdesen për këtë çështje për të mos lejuar të shkelen ligjet dhe të paguajnë çmime më të larta se sa çmimi zyrtar i cili është nxjerr nga institucioni kompetent Ministria e Shëndetësisë.

Po të ishte lejuar mos respektimi i ligjeve atëherë edhe ne do të kishim ofertuar me çmime më të larta, por ne i jemi përmbajtur të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, dhe në këtë mënyrë ne po ndëshkohemi nga institucionet e të cilat janë përgjegjës për respektim të ligjeve përkatëse në fuqi.

- OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti në këtë aktivitet të prokurimit ka bashkangjitur CE Certifikatën e produkteve dezinfektuese, e ku në scan kod vërtetohet se kjo certifikatë është e revokuar dhe nuk përdoret, prandaj dyshojmë se është falsifikuar apo ka ndërhyrje në këtë certifikatë.

Bashkangjitur e gjeni likun për verifikim për këtë certifikatë të lëshuar nga DQS Global me numër të certifikatës 004567 MDR2017B ([DQS - Certificate validation](#))

Kur shënohet numri i certifikatës shfaqet pamja si më poshtë:

Certificate validation

You want to check the validity of a DQS certificate?

Home / About / Impartiality and Compliance / Certificate validation

The certification

**Schülke & Mayr GmbH**

004567 MDR2017B

VO (EU) 2017/745 Anhang IX- Bewertung der technischen Dokumentation

from

15.12.2023 \*

is currently withdrawn!

Find your certification

Company name \*

City

Submit

Me këto shënime dhe të dhëna, dyshojmë se ka ndërhyrje në këtë certifikatë, prandaj kërkojmë nga AK-së që të korrigojë njoftimin mbi vendimin dhe të eliminojë grupin e OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa ofertën tonë ta shpall të përgjegjshme.

Nga procesverbali i hapjes së ofertave dhe nga njoftimi mbi vendimin shihet se ne kemi ofertuar me çmim prej 12.56€, kurse grupi i OE të rekomanduar 56.00 €, e që i bie se 43.44€ jemi më të lirë se sa grupi i OE të rekomanduar për kontratë.

Të rrezikohet të dëmtohet buxheti në këtë vlerë është absurditet i llojit të vet, pasi që i bie të shpallet fitues një kompani me çmim prej rreth 366.67% më shtrenjtë se sa oferta jonë.

**Ne me dt.08.05.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, por që në asnjë mënyrë nuk është dhënë asnjë dëshmi konkrete përmes të cilës dëshmohet e kundërta e pretendimeve tona ankimore.**

- AK-ja sa i përket pretendimit tonë ankimor në lidhje me arsyen e eliminimit tonë është përgjigj si në vijim:

*Përgjigje: Refuzohet si e pabazuar pretendimi juaj pasi që specifikacionet e kerkuara me ato te ofruara jane mbi 80% te ndryshme nga permbajtja dhe jane produkte jo-te barazvlefshme.*

Arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, sepse konstatimi se produktet tona janë “80% të ndryshme”, është dhënë pa prezantuar asnjë analizë teknike apo raport profesional se si është nxjerr një konstatim i tillë. Ne me kërkesë për rishqyrtim kemi dorëzuar ekspertizë profesionale nga eksperti gjyqësor Farmacist Specialist, i cili ka vërtetuar faktin se produktet e ofruara nga ana jonë janë ekuivalente. AK-ja nuk e ka analizuar fare këtë ekspertizë dhe nuk ka ofruar ndonjë fakt konkret se ku është bazuar që produktet tona nuk janë të barazvlefshme. Përderisa gjatë fazës para dorëzimit të ofertave përmes sqarimeve shtesë është lejuar ofertimi me produkte ekuivalente, atëherë AK-ja ka qenë e obliguar të bëjë vlerësim objektiv dhe jo diskriminues, pasi që produktet tona plotësojnë kërkesat e shënuara tek specifikat teknike dhe njëkohësisht të njëjtat janë konform sqarimeve shtesë të lejuara nga ana e AK-së.

AK-së nuk ka dhënë përgjigje fare sa i përket prezantimit të ekspertizës së ekspertit gjyqësor - Farmacist-Specialist i Toksikologjisë z. Nardi Sh. Sheqerxhiu prandaj nga ky fakt kuptohet tendenca e AK-së në drejtim të favorizimit të OE të rekomanduar për kontratë dhe diskriminimit të kompanisë tonë. Të mos jepet përgjigje fare në lidhje me ekspertizën e prezantuar dhe atë nga një ekspert gjyqësor, nuk ka se si të kuptohet ndryshe përveç se tendencë diskriminuese dhe veprime të kundërligjshëm të autoritetit kontraktues.

Ekspertiza është e përgatitur nga një profesionist dhe ekspert i gjykatës i cili ka gjitha kompetencat dhe kualifikimet e duhura, **Kimist i diplomuar, Farmacist i diplomuar dhe Specialist i Toksikologjisë**, ndërsa asnjëri prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit nuk ka një kualifikim të tillë profesional në aspektin e përbërjes së produkteve.

Njëkohësisht duhet sqaruar fakti se, vetë AK-ja në përgjigjen e saj për pretendimet tona kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, e pranon se edhe OE i rekomanduar ka ofertuar me produkte jo identike me specifikimet e dosjes së tenderit, por i ka konsideruar si të pranueshme. Kjo tregon qartë trajtimin e pabarabartë dhe diskriminues ndaj kompanisë tonë, e që këto veprime bien në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

- Në lidhje me pretendimin tonë ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë për mos përputhje të dokumentacionit me mostrat e ofruara, AK-ja ka dhënë arsyetimin si në vijim:

**Pergjigje:** Refuzohet si i pabazuar pretendimi per dokumente si tendence mashtrimi apo mos dorezimi i dokuemteve adekuate per arsye se OE i rekomanduar per kontrate ka dorezuar ISO dhe CE e prodhuesit sipas kerkesave ne dosjen e tenderit.

Ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar dhe është në kundërshtim të plotë me pretendimin tonë ankimor, pasi që pretendimi ynë nuk ka qenë mungesa e certifikatave ISO apo CE, por mospërputhja substanciale ndërmjet mostrave të dorëzuara dhe dokumentacionit të dorëzuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë.

Pra, kemi shmangie të dhënies së përgjigjes në lidhje me mostrat dhe dokumentacionin për mostra të OE të rekomanduar për kontratë.

Ne e kemi sqaruar qartë se mostrat e dorëzuara nga i njëjti OE janë nga “S&M Waschlotion 1L” dhe “Mikrozid AF Liquid 1L”, ndërsa dokumentacioni i prezantuar në ofertë ka qenë për produkte tjera, konkretisht “Desmanol Pure” dhe “Sensiva Waschlotion”. Ky fakt përbën mospërputhje substanciale dhe materiale ndërmjet mostrës dhe dokumentacionit teknik.

AK-ja në arsyetimin e saj nuk e ka mohuar këtë fakt në asnjë mënyrë dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim se si dokumentacioni i ofruar për një produkt mund të konsiderohet valid edhe për mostra të një produkti tjetër.

Fakti që OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar certifikata ISO dhe CE nuk e dëshmon të kundërtën e pretendimit tonë ankimor, pasi që certifikatat mund të jenë valide për një produkt, por jo domosdoshmërisht për mostrën e dorëzuar. Andaj kur kemi parasysh këtë fakt shihet qartë se autoriteti kontraktues ka dhënë një arsyetim të pa bazuar dhe të pa mbështetur në dëshmi konkrete, por më shumë është dhënë një arsyetim i cili favorizon OE të rekomanduar për kontratë. Këto ndryshime dhe mospërputhje të dokumentacionit me mostrat janë elemente që dëshmojnë qartë dhe substancialisht pa përgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë.

- Sa i përket pretendimit tonë ankimor në lidhje me çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë, AK-ja ka dhënë arsyetimin si në vijim:

**Refuzohet si i pabazuar pretendimi juaj pasi qe komisioni i vleresimit e ka trajtuar si oferte e pergjegjshme me cmimin me te lire**

Pra AK-Komuna jone nuk e ka praktikuar kete liste ne vleresim per shkak se nuk ka qene kriter i dosjes se tenderit dhe nuk kemi bere vleresim te njeanshem.

Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm sepse Ligji për Çmimin e Produkteve Medicinale është ligj detyrues dhe zbatimi i tij nuk varet nga fakti nëse është përmendur apo jo në dosjen e tenderit. Autoriteti kontraktues nuk mund dhe nuk duhet që në asnjë mënyrë të mos i respektoj dispozitat detyruese të ligjeve në fuqi me arsyetimin se ato nuk janë përfshirë si kriter në dosje. Neni 14 i Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale përcakton qartë se baza për përcaktimin e çmimit të blerjes nga institucionet publike është lista zyrtare e çmimeve të publikuara nga Ministria e Shëndetësisë. Kjo dispozitë ka karakter obligativ dhe AK-ja ka qenë e detyruar ta respektoj të njëjtin gjatë vlerësimit të ofertave, mirëpo që një veprim i tillë nuk është bërë me qëllim që të favorizohet OE i rekomanduar për kontratë.

Edhe paga minimale nuk ceket si kriter nëpër dosje të tenderit por është obligative të respektohet nëpër ofertime nga OE ofertues, prandaj edhe çmimet e barnave janë detyruese për të gjithë operatorët ekonomik dhe obligative të merren parasysh nga institucionet dhe autoritete kontraktuese.

Nëse nuk merren parasysh këto çmime atëherë vetë autoriteti kontraktues po vepron në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe njëkohësisht me vetëdije të plotë po pranon dëmtimin e buxhetit të shtetit dhe favorizimin e një kompanie të caktuar, e që në fakt kjo përbën vepër penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 i KPRK i zyrtarëve përgjegjës të autoritetit kontraktues dhe këto keqpërdorime ne do ti paraqesim tek organet kompetente.

Kur kemi parasysh faktin e lartcekur shihet qartë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm dhe njëkohësisht vet AK-ja e ka pranuar se nuk është respektuar neni 14 i Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale.

- Për pretendimin tjetër kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, sa i përket certifikatës së produkteve dezinfektuese, AK-ja ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Refuzhet si i pabazuar pretendimi juaj se Certifikata e dorezuar ne oferte eshte ma validitet dhe ka gjithte te dhenat sipas kerkesave ne dosjen e tenderit.

Ky arsyetim i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm dhe njëkohësisht nuk trajton thelbin e pretendimit tonë, por është shmangie nga pretendimi ynë.

Në kërkesë për rishqyrtim ne e kemi sqaruar se përmes verifikimit të scan kodit të certifikatës së lëshuar nga DQS Global, konkretisht certifikatës me numër 004567 MDR2017B, rezulton se certifikata është e revokuar dhe nuk figuron si certifikatë valide.

AK-ja nuk ka paraqitur asnjë verifikim zyrtar nga organi certifikues, nuk ka dhënë asnjë raport verifikimi dhe nuk ka kundërshtuar faktin e revokimit të certifikatës, por ka dhënë një arsyetim krejtësisht të paqëndrueshëm duke e cekur vetëm se certifikata është me validitet. Arsyetimi i AK-së se certifikata “është me validitet” nuk mjafton në një rast të tillë ku është paraqitur provë konkrete përmes sistemit të verifikimit online të vetë institucionit certifikues. Në këtë rast, AK-ja ka qenë e obliguar që të bëjë një verifikim shtesë për të vërtetuar vlefshmërinë e certifikatës, mirëpo që një veprim të tillë e njëjta nuk e ka bërë, duke e favorizuar haptas OE të rekomanduar për kontratë.

Vetëm kur ngritet një dyshim për falsifikim apo ndërhyrje, autoriteti kontraktues duhet menjëherë të bëjë verifikimin e dokumentit, e leje më kur ofrohen dëshmi se certifikata e tillë rezulton se nuk është valide dhe është e revokuar.

Autoriteti kontraktues, në këtë rast me vetëdije të plotë përkrah OE e rekomanduar për kontratë duke mos shpreh interesim fare të bëjë verifikim të dokumenteve të tij.

Kërkojmë nga eksperti i OSHP-së që të bëjë këtë verifikim me qëllim që të qartësohet situata në lidhje me këtë certifikatë.

- Në lidhje me pretendimin tonë ankimor se Specifikimet teknike të grupit të OE të rekomanduar për kontratë nuk janë sipas specifikimeve teknike të dosjes së tenderit, mirëpo pasi është lejuar ekuivalenca konsiderojmë se edhe këto specifika të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë duhet të merren parasysh por jo të diskriminohemi ne, autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje.

Vetë fakti, i mos dhënies së një përgjigjeje në lidhje me këtë pretendim tregon qartë se specifikimet e OE të rekomanduar për kontratë janë të brazvlefshme me kërkesat e dosjes së tenderit, ashtu siç edhe ne i kemi ofruar.

Kur kemi parasysh faktet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, prandaj i njëjti nuk mund dhe nuk duhet të merret nga ana e panelit shqyrtues të OSHP-së.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me **çmimin më të ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *“Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”,* mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse ka rekomanduar për kontratë një OE që ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

**Kërkojmë nga OSHP-ja që të mos caktojë eksperte teknike znj. Gëzime Pllana, pasi që e njëjta në secilën lëndë dhe ankesë që e kemi parashtruar dhe që ajo e ka shqyrtuar ka qenë e njëanshme dhe subjektive.**

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

#### **VENDIM**

- I. APROVOHET,** e bazuar ankesa e OE **“MEDPLUS SH.P.K**
- II. ANULOHET,** njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-s.

### **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

## **v10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*